- **Njësia përgjegjëse:** Sektori i Rrugëve Rurale
- **Përshkrimi:**
  Përgatitja e dosjeve për të gjitha punimet që janë kryer gjatë muajit.
  Firmosja e tyre nga Përgjegjësi i sektorit ,Ekonomistit ,Tekniku i sektorit dhe të gjithë personat pergjegjes që kanë kryer punimet .
  Hedhja çdo ditë e kohëshënuesit .
  Mbajtja e korespodencës me njësitë e tjera jashtë sektorit.
  Monitorimi i karburantit për cdo mjet,në çdo kohë.**Kuadriligjor:**Ligji nr. 139/2015,
- **Koha:** Çdo ditë.

7. Sektori i rrugëve rurale

- **Nenprocesi:**
  1.Bërja e planit mujor mbi kryerjen e të gjithë aktiviteteve të sektorit .
  2. Bërja e listës së punimeve ku do punohet për gjithë muajin .
  3. Rregjistrimi i kohëshënuesit .
- **Objektivi:** Përgatitja dhe hartimi i prevetivave për çdo punim.
- **Njësia përgjegjëse:** Sektori i Ujitje -Kullim
- **Përshkrimi:**
  Bërja e dosjeve gati të të gjithë punimeve që janë kryer për gjithë muajin .Firmosja nga specialistët ,eskavatoristët ,ekonomistja ,përgjegjësi .
  Hedhja cdo dite e kohëshënuesit ,mbajtja e korispodencës me sektorët e tjerë .

Llogaritja e naftës për çdo eskavator
Koha: Çdo ditë.

Agjencia e Shërbimeve Publike angazhohet për realizimin me përgjegjësi të plotë,duke garantuar menaxhim profesional, kontroll administrativ dhe eficiencë në përdorimin e burimeve publike.

Konceptoi
Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve
Eridjon Rustemi

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
GËZIM TOÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
Drejtoria Juridike dhe Prokurimet Publike

Proceset e Punës – Gjurmet e Auditit viti 2025

1. Procesi: Hartimi dhe verifikimi i akteve juridike

- Nënprocesi: Draftimi i akteve, verifikimi ligjor, miratimi.

- Objektivi: Sigurimi i përputhshmërisë së akteve me ligjin dhe rregulloret vendore.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria Juridike harton aktet administrative, i verifikon për bazë ligjore dhe i paraqet për miratim tek Kryetari i Bashkisë ose Këshilli Bashkiak.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; aktet nënligjore për funksionimin e bashkive.

- Koha: Për çdo akt të ri ose ndryshim ligjor, sipas afateve të përcaktuara.

2. Procesi: Konsulenca ligjore për drejtoritë e bashkisë

- Nënprocesi: Këshillimi ligjor, interpretimi i ligjit, dhënia e mendimit juridik.

- Objektivi: Mbështetja e drejtorive të tjera në zbatimin korrekt të ligjit.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria Juridike ofron mendime ligjore për procedurat e brendshme, kontratat dhe vendimet administrative.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; Ligji nr. 139/2015.

- Koha: Në mënyrë të vazhdueshme, sipas kërkesave të drejtorive.

3. Procesi: Përfaqësimi ligjor i bashkisë

- Nënprocesi: Përgatitja e dosjeve gjyqësore, ndjekja e proceseve në gjykatë.

- Objektivi: Mbrojtja e interesave të Bashkisë Maliq në gjykata dhe institucione.

- Përshkrimi i procesit: Juristët e drejtorisë përfaqësojnë bashkinë në çështje gjyqësore, përgatisin dokumentacionin dhe ndjekin vendimet gjyqësore.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 8116/1996 "Kodi i Procedurës Civile"; Ligji nr. 139/2015.

- Koha: Sipas afateve gjyqësore dhe kërkesave të institucioneve.

4. Procesi: Mbikëqyrja e kontratave dhe marrëveshjeve

- Nënprocesi: Kontrolli i përputhshmërisë ligjore, interpretimi i klauzolave, monitorimi i zbatimit.

- Objektivi: Sigurimi që kontratat dhe marrëveshjet e bashkisë janë ligjërisht të vlefshme dhe të zbatueshme.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria Juridike shqyrton kontratat e prokurimeve dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, duke garantuar respektimin e ligjit.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimet Publike"; Ligji nr. 7850/1994 "Kodi Civil".

- Koha: Para nënshkrimit të kontratave dhe gjatë zbatimit të tyre.

5. Procesi: Monitorimi i përputhshmërisë ligjore

- Nënprocesi: Kontrolli i akteve, raportimi i shkeljeve, rekomandimi i masave.

- Objektivi: Parandalimi i shkeljeve ligjore dhe sigurimi i transparencës.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria Juridike monitoron veprimtarinë e bashkisë për përputhshmëri me ligjin dhe raporton tek Kryetari i Bashkisë.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 139/2015; Ligji nr. 44/2015.

- Koha: Periodikisht, sipas planit vjetor të punës.

6. Procesi: Planifikimi i prokurimeve publike

- Nënprocesi: Hartimi i planit vjetor të prokurimeve, miratimi nga Këshilli Bashkiak.

- Objektivi: Sigurimi i transparencës dhe planifikimit të qartë të nevojave të bashkisë.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria përgatit planin e prokurimeve bazuar në buxhetin dhe nevojat e njësive, e paraqet për miratim dhe e publikon sipas ligjit.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimet Publike"; udhëzimet e APP.

- Koha: Çdo fillim viti buxhetor.

7. Procesi: Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

- Nënprocesi: Hartimi i dokumenteve standarde, përcaktimi i kritereve, publikimi i njoftimit.

- Objektivi: Sigurimi i konkurrencës së ndershme dhe dokumentacionit të plotë.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria përgatit dokumentet e tenderit sipas formatit standard, i publikon në sistemin elektronik të APP dhe njofton palët e interesuara.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020; VKM për dokumentet standarde të prokurimit.

- Koha: Para çdo procedure prokurimi.

8. Procesi: Administrimi i procedurës së prokurimit

- Nënprocesi: Hapja e ofertave, vlerësimi i tyre, shpallja e fituesit.

- Objektivi: Zbatimi i procedurës së drejtë dhe transparente.

- Përshkrimi i procesit: Komisioni i vlerësimit të ofertave shqyrton dokumentacionin, bën pikëzimin dhe shpall fituesin sipas kritereve të përcaktuara.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020; rregulloret e APP.

- Koha: Gjatë çdo procedure prokurimi.

9. Procesi: Nënshkrimi i kontratës

- Nënprocesi: Përgatitja e kontratës, verifikimi ligjor, nënshkrimi nga palët.

- Objektivi: Sigurimi i vlefshmërisë ligjore të kontratës dhe mbrojtja e interesave të bashkisë.

- Përshkrimi i procesit: Pas shpalljes së fituesit, Drejtoria përgatit kontratën, e verifikon me Drejtorinë Juridike dhe e nënshkruan me operatorin ekonomik.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 7850/1994 "Kodi Civil"; Ligji nr. 162/2020.

- Koha: Pas përfundimit të procedurës së prokurimit.

10. Procesi: Monitorimi i zbatimit të kontratës

- Nënprocesi: Kontrolli i afateve, cilësisë së punimeve/shërbimeve, raportimi i ecurisë.

- Objektivi: Sigurimi i realizimit të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria monitoron zbatimin e kontratës, raporton për ecurinë dhe ndërmerr masa në rast shkeljesh.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020; kontratat e nënshkruara.

- Koha: Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

11. Procesi: Raportimi dhe arkivimi

- Nënprocesi: Raportimi i procedurave të kryera, arkivimi i dosjeve të prokurimit.

- Objektivi: Sigurimi i transparencës dhe ruajtjes së dokumentacionit për auditim.

- Përshkrimi i procesit: Drejtoria përgatit raportet periodike për procedurat e kryera dhe arkivon dosjet sipas rregullave të administratës publike.

- Kuadri ligjor: Ligji nr. 162/2020; Ligji nr. 4/2010 "Për Auditimin e Brendshëm".

- Koha: Periodikisht, sipas planit vjetor të punës.

Konceptoi:

Drejtori i Drejtorise

Genci Floqi

Miratoi:

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MARIUS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

Maliq 2025

IMT funksionon në bazë të ligjit nr.9780 dt.16/07/2007 i ndryshuar me ligjin nr.183/2014 neni 5,12 ka të drejtë të hyjë,kontrollojë në objekte ku kryhet ndërtimi dhe ka këto detyra:

Detyrat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit

(Objektivat)

1. Vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territotit.
2. Vendos gjoba,sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territotit.
3. Paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të liçencës profesionale,personale ose të shoqërisë,në rast të ndërtimit të kundërligjshëm,si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit,projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit.
4. Vendos pezullimin e punimeve/ndertimeve në rastin kur nje afat kohor paraprak është I nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territotit.
5. Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.
6. Përgatit kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrolit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse,sipas ligjit në fuqi.
7. Detyrohet të japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorrit brënda një afati kalendarik 5-ditor nga data e marrjes së kërkesës,si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektoriati.
8. Merr vendim zhdëmtimi në ngakim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme.
9. Përgatit dhe i jep të dhëna IKMT për masat e marra.

Regjistri i riskut

IMT Bashkia Maliq gjatë ushtrimit të funksionit të saj ka analizuar risqet që ndikojnë në përmbushjen e detyrave të saj parashikuar në ligjin nr.9780 dt.16.07.2007 I ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 neni 5,si edhe akteve të tjera ligjore në fushën e mdërtimeve.

- Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara në ligjin nr.183/2014 neni 5.Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore, bazuar në nenin 4 të po këtij ligji, detyrim i cili ndikon direkt në realizimin me efektivitet të detyrave.

- Mungesa e informacionit të nevojshëm nga strukturat e Njësive Administrative apo institucioneve të tjera që kanë më shumë mundësi në kontrollin e territorit apo kontakt më të shpeshtë me komunitetin.

- Ushtrimi i funksionit në një territorr administrativ me shtrirje mjaft të gjërë dhe reliev të thyer,krijon vështirësi në ushtrimin e përgjegjesive të saj.

- Për mos ushtrimin e funksionit me efektivitet të plotë IMT është e ekspozuar ndaj penaliteteve që i përcakton ligji nr.183/2014 neni 15.

- Përmbushja e detyrimeve ligjore të përmëndura më sipër do të minimizonte riskun eventual gjatë kryerjes dhe funksionimit të IMT-së.

Miratoi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Institucioni: Bashkia Maliq
Dokumenti: Gjurmët e auditimit për Njësinë e AB-së,
Përgatitur nga: Njësia e Auditimit të Brendshëm
Viti 2025

Emërtimi i proçesit	Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor i AB-së.
Nën - proçesi	1. Plani Strategjik dhe Vjetor për periudhën 2025-2027; 2. Përcaktimi i qëllimit të planit strategjik dhe misioni i NJAB-së, organizimi i NJAB-së dhe kuadri ligjor, objektivat strategjik, identifikimi i subjekteve, identifikimi i fushave prioritare, identifikimi dhe vlerësimi i risqeve; 3. Plotësimi i pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2 sipas formatit standart. 4. Hartimi i pasqyrës nr. 3 plani i angazhimit të NJAB për vitin, planifikimi i nevojave për trajnimin e NJAB dhe planifikimi i buxhetit.
Objektivi i proçesit	Hartimi i Planit Vjetor dhe Strategjik mbi bazën e të cilit do të zhvillohen auditimet.
Njësia përgjegjëse	Njësia e Auditimit të Brendshëm (përgjegjësi i njësisë).
Përshkrimi i proçesit	Plani Strategjik dhe Vjetor i NJAB hartohet nga përgjegjësi i njësisë të AB dhe miratohet nga Kryetari i Bashkisë. Ky plan dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
Kuadri ligjor	Ligji nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.
Koha	Brenda datës 20 Tetor të çdo viti.

Emërtimi i proçesit	Kryerja e Auditimit në subjekt.
Nën - proçesi	1. Planifikimi i auditimit; 2. Hartimi i Planit të Angazhimit të Auditimit; 3. Autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim; 4. Deklarata e Konfliktit të Interesit të Audituesit të Brendshëm; 5. Urdhërshërbimi; 6. Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit; 7. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit; 8. Vlerësimi i riskut për sisteme e fusha të veçanta; 9. Takimi fillestar me organizatën që do të auditohet; 10. Puna në objekt dhe konstatimet e gjetjeve nëpërmjet testeve përkatëse; 11. Takimi përmbyllës ku do të diskutohet për projekt-raportin që do të hartohet, rënia dakort me gjetjet; 12. Hartimi i projekt-raportit dhe dërgimi në subjektin e audituar; 13. Administrimi i kundërshtive dhe argumentave të tjera shtesë nëse ka nga subjektet; 14. Hartimi i Raportit Final dhe dërgimi në subjektin e audituar; 15. Sygjerimi i planit të veprimit për subjektin; 16. Hartimi i memos për Kryetarin e Bashkisë lidhur me auditimin e kryer; 17. Hartimi i Planveprimit nga subjekti i audituar dhe administrimi në dosjen e auditimit; 18. Përpilimi i urdhërit të Kryetarit të Bashkisë për adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna subjektit; 19. Rishikimi i cilësisë së punës nga përgjegjësi i grupit të auditimit; 20. Rishikimi i cilësisë së punës nga drejtuesi i njësisë së auditimit; 21. Përpilimi i dosjes dhe inventarizimi i saj.
Objektivi i proçesit	Kryerja e angazhimit të auditimit në terren, rënia dakort me gjetjet nga auditimi si dhe dhënia e rekomandimeve për organizatën me synim përmirësimin e punës në të ardhmen.
Njësia përgjegjëse	Njësia e Auditimit të Brendshëm (përgjegjësi i njësisë), grupi i auditimit, përgjegjësi i grupit.
Përshkrimi i proçesit	Zhvillimi i një angazhimi auditimi që nga planifikimi, puna në terren, konstatimi i gjetjeve, dhënia e rekomandimeve dhe plotësimi i të gjithë raportimit deri në hartimin përfundimtar të dosjes.
Kuadri ligjor	Ligji nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.
Koha	Për çdo auditim të kryer.

Emërtimi i proçesit	Raportimi i Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin ushtrimor.
Nën - proçesi	1. Raporti i gjithë veprimtarisë 1-vjeçare të AB-së për të gjitha angazhimet e kryera; 2. Të dhënat për burimet njerëzore të AB-së të përdorura për vitin; 3. Realizimi i Planit të Angazhimit për vitin; 4. Përmbledhësja e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e realizuara gjatë vitit; 5. Përmbledhja e parregullshmërive të identifikuara sipas sistemeve për vitin; 6. Rekomandimet e dhëna nga NJAB sipas kategorive për vitin; 7. Çështjet e dërguara për investigim për vitin; 8. Informacion për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditimit; 9. Hartimi dhe plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit për AB-në; 10. Raportimi tek Kryetari i Bashkisë për veprimtarinë 1-vjeçare brenda datës 15 Shkurt; 11. Raportimi në Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
Objektivi i proçesit	Raportimi i veprimtarisë 1-vjeçare të NJAB-së, përmirësimi i punës në vitet në vazhdim.
Njësia përgjegjëse	Përgjegjësi i njësisë.
Përshkrimi i proçesit	Nxjerrja e të dhënave përmbledhëse mbi veprimtarinë 1–vjeçare të AB-së, analizimi i treguesve, adresimi i problematikave dhe raportimi në Kryetari i Bashkisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtori e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
Kuadri ligjor	Ligji nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.
Koha	Brenda datës 15 Shkurt të çdo viti.

Konceptoi: Përgjegjës A. Beqiraj

Miratoi

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

MIRATUAR
KRYETARI

GEZIM TOPÇIU

PROCESET PER MENAXHIMIN E TE ARDHURAVE VENDORE

Dokumentimi i Proceseve, ndryshe Gjurma e Auditit te Proceseve[1],jep një pamje të përgjithshme të ndërlidhjeve ndërmjet proceseve dhe strukturave të ndryshme të bashkisë dhe sherben si model udhërrëfyes i të gjitha niveleve të menaxhimit të Bashkisë për implementimin e kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin me fokus në menaxhimin e rreziqeve. Ai siguron që të gjitha operacionet e bashkisë të dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, Këshillit Bashkiak dhe audituesve të jashtëm të kuptojnë mjedisin e kontrollit[2]. Ai synon uniformitet në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësive për kryerjen e një aktiviteti si dhe afatin kohor në të cilin duhen zbatuar, duke mundësuar kështu përmbushjen e objektivave te procesit dhe ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe monitorimin[3].

Përmbajtja

PROCESI 1: Parashikimi i të Ardhurave të Veta Vendore 2

Seksioni 1. HARTA e PROCESIT "Parashikimi i të Ardhurave te Veta Vendore" 2

[1]Emertimi sipas Ligjit 10296/2010 (i rishikuar), neni 16

[2] Në referencë me Nenin 16 të Ligjit 10296/2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» (i rishikuar)

[3] Në referencë me Nenin 22 të Ligjit 10296/2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» (i rishikuar)

PROCESI I: Parashikimi i të Ardhurave të Veta Vendore

Kodi i Procesit: ***PAV -1***

***Udhëhequr/përgatitur nga*:** **Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, DATTV**

Date: **viti fiskal 2025**

Seksioni 1. HARTA e PROCESIT "Parashikimi i të Ardhurave te Veta Vendore"

Emri i Procesit	**Parashikimi i te Ardhurave te Veta Vendore**
Nenproceset dhe Hapat kronologjike	**Nenprocesi I – Vleresimi dhe planifikimi financiar i te ardhurave vendore per 3 vitet e ardhshme** 1. Ngritja/Mbledhja e Grupit te punës per Parashikimin e te Ardhurave Vendore; 23. Hartimi i Kalendarit te PBA 4. Miratimi - Kalendarit te programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor 5. Njohja me dokumentacionin baze per vleresimin afatmesem te te ardhurave vendore 6. Analiza e te dhenave financiare qe lidhen me vleresimin e parashikimeve afatmesme të te ardhurave. 7. Koordinimi me Nepunesin Zbatues per Raportin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm. 8. Miratimi i Raportit te Veresimeve dhe Parashikimit Afatmesem te te ardhurave vendore **Nenprocesi II: Parashikim per cdo kategori te te ardhurave dhe propozimi per ndryshimet e pritshme në politikat fiskale vendore.** 9. Perditesimi/detajimi i parashikimit te te ardhurave vendore sipas tipologjise se te ardhurave te veta. 10. Koordinimi me Ekipet e Programeve Buxhetore dhe analiza e risqeve; 11. Analiza e thelluar e risqeve dhe marrja e vendimit per burimin e mbulimit proporcional te kostove. 12. Projekt dokumenti i PBA 13. Komunikimi me Ministrine e Financave dhe Ekonomise 14. Shqyrtimi / Miratimi nga Keshilli Bashkiak. **Nenprocesi III – Rishikimi i Programit Buxhetor Afatmesem** 15. Rishikimi i parashikimeve te te ardhurave, si pjese e procesit te PBA se rishikuar. 16. Konsultimi Publik 17. Miratimi nga KB dhe komunikimi me MFE **Nenprocesi IV. Finalizimi i Programit Buxhetor Afatmesem dhe Vjetor** 18. Përgatitja e projekt buxhetit vjetor 19.Plani i arkes dhe percaktimi i afateve te pageses ne paketen fiskale 20. Miratimi i PBA finale, buxhetit vjetor dhe ndryshimet finale ne paketen fiskale.
Objektivi strategjik per procesin	Parashikimi të ardhurave realiste në funksion të strategjisë së zhvillimit dhe mirëqeverisjes vendore
Objektivat Operativë të lidhura me nënproceset	1. Formalizimi dhe aktivizimi i strukturave perkatese per arritjen ne kohe dhe me cilesi te hartimit te buxhetit dhe parashikimeve te te ardhuruave 2. Vlerësim dhe planifikimfinanciar i të ardhurave bazuar në ekspertizë, si dhe në bazë të analizës së prirjeve kryesore ekonomike, demografike, fiskale, sociale, duke e pershtatur me termat kohore te PBA. 3. Parashikim realist dhe i thelluar i të ardhurave bazuar në ekspertizë, në bazen e tatueshme, deklarimet tatimore te taksapaguesve per vitin aktual, duke konsideruar kostot e sherbimeve vendore dhe risqeve qe sjellin politikat e reja. 4. Perditesimi dhe konsolidimi i dokumentit te parashikimit te të ardhurave bazuar në ekspertizë dhe i paketes fiskale te rishikuar, duke konsideruar informacionin me te fundit per burime financiare shtese dhe ndryshimet me te fundit te legjislacionit.

	5. Konsolidimi i dokumentit te parashikimit te të ardhurave vjetore dhe i paketes fiskale te rishikuar, duke konsideruar informacionin me te fundit mbi ndryshimet e legjislacionit dhe nevojen per burime financiare
Objektivi i Procesit– Pajtueshmëria	Parashikimet e të ardhurave vendore duhet të përputhen me kërkesat e kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërise: - Ligji nr. 139/2015,"Per vetëqeverisjen vendore" - Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar -Ligji nr.9936/2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar - Vendime te Keshillit Bashkiak - Ligji nr. 68, date 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" - Ligji 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i rishikuar; - VKM 132/2018 "Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajthshme ndertesa, e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses, si dhe te kritereve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses" (i rishikuar ne vitin 2019, 2020). - Udhëzimi i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.23, date 28.02.2018 "Për procedurat standarde te përgatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm per Bashkite"
Objektivi i Procesit – Afatet Raportimi	Ky proces zbatohet gjatë gjithë vitit fiskal ne perputhje me kalendarin e pergatitjes se programit buxhetor afatmesem dhe vjetor te bashkise. Afatet e meposhthme kryesisht janë te vendosura me Ligj dhe me Urdherin për miratimin e ketij procesi (gjurme auditimi sipas ligjit). 1. Kalendari i PBA miratohet deri ne 31 dhjetor viti paraardhes. 2. Miratimi i raportit për vlerësimet afatmesme të të ardhurave nga Keshilli bashkiak deri ne 1 Mars viti korrent. 3. Raporti me propozimet per rishikimin e paketes fiskale ne te njejten periudhe me dokumentin e pare te PBA deri ne 31 Maj. 4. Komunikimi me MFE dhe miratimi i dokumentit te pare te PBA (perfshi propozimet e paketes fiskale dhe parashikimi i te ardhurave) nga Keshilli deri ne 30 Qershor. 5. Konsultimi me publikun dhe miratimi i dokumentit te rishikuar te PBA nga KB deri ne 15 Shtator. 6. Dergimi ne Keshill i dokumentit perfundimtar te PBA, perfshi ndryshimet e paketes fiskale, parashikimin perfundimtar te te ardhurave deri ne 30 Nentor. 7. Miratimi i dokumentit perfundimtar te PBA dhe parashikimi vjetor i te ardhurave nga Keshilli Bashkiak deri ne 25 Dhjetor. 8. Publikimi i paketes fiskale te perditesuar brenda 15 diteve nga miratimi në Keshill.
Njësia/Struktura Përgjegjëse në Bashki	Koordinatori i GMS dhe Drejtuesi për Taksat dhe Tarifat Vendore.
Të tjera Subjekte dhe struktura të përfshira në proces	Kryetari i Bashkisë dhe cdo strukture brenda bashkise (anetare dhe koordinatore te GMS), Grupi teknik i koordinimit të risqeve të bashkise; Institucione të tjera: Ministria e Financave, Qendra Kombetare e Biznesit, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, INSTAT, DPSHTRR, DPT
Përshkrimi i Procesit	Pas Planit Strategjik të Zhvillimit/ Planit përgjithshëm Vendor, planifikimi i të ardhurave është elementi thelbësor në përcaktimin e burimeve në dispozicion të bashkise në të dy rastet, afatshkurtër dhe afatmesëm. Bashkia financohet nga të ardhurat që sigurohen nga: - taksat dhe tarifat vendore, te ardhurat nga menaxhimi i aseteve dhe të tjera te ardhura jotatimore te parashikuara me ligj;

	- nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore si transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike për funksionet Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar; - fondet që vijnë nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare; - huamarrja vendore dhe donacione/grante te brendshme dhe te jashtme. Buxheti vjetor lidhet drejtpërdrejt me planifikimin afatmesëm: ai përbën vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm. **Në fazën para planifikimit**përfshihet: (i) ngritja/takimi i parë i Grupit për Menaxhim Strategjik, GMS dhe ngritja e ekipeve të Menaxhimit të Programeve, EMP; (ii) njohja me programet buxhetore dhe politikat përkatëse të tyre; (iii) renditja e prioriteteve sipas Planit të përgjithshëm vendor dhe lidhja e tyre me funksionet dhe programet buxhetore; (iv) miratimii kalendarit për hartimin e buxhetit afatmesëm PBA. Kjo fazë mbyllet **jo më vonë se** data 31 dhjetor të çdo viti fiskal, duke i paraprirë fazës së parë të planifikimit afatmesëm qe fillon në datën 1 janar të vitit fiskal pasues. Parashikimi i të ardhurave vendore dhe hartimi/rishikimi i paketës fiskale te bashkisëështë proces ciklik ndjek ritmin e përgatitjes së PBA dhe buxhetit vjetor duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në kalendarin për përgatitjen e buxhetit afatmesëm dhe vjetor. Konkretisht parashikimi i të ardhurave dhe rishikimi i politikave fiskale/paketes fiskale jane dy nënprocese që ecin paralelisht, por parashikimi vjetor konsolidohet ose përditësohet njëkohësisht ose pas miratimit përfundimtar të ndryshimeve në paketën fiskale të bashkisë. **Këto dy dokumente janë pjesë përbërëse e paketës së PBA dhe miratohen njëkohësisht në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.** GMS-ja do të mbështetet në këto parashikime për realizimin e vlerësimeve të tyre mbi tavanet e programit për periudhën e PBA, duke marrë në konsideratë nevojat dhe prioritetet e programit, kërkesat për projekte/produkte të reja në periudhën afatmesme. **Faza Strategjike e planifikimit fillon ne muajin Janar** te cdo viti me kryerjen e vleresimit dhe parashikimin financiar te përgjithshëm te ardhurave afatmesme, bazuar ne: (i) analizen e te dhënave mbi te ardhurat e realizuara per te vlerësuar paraprakisht eficiencen e politikave fiskale te zbatuara (ii) politiken fiskale (paketën fiskale) te miratuar nga keshilli bashkiak në fund te vitit te sapombyllur, (ii) në përputhje dhe të përditësuar me politikat e reja të miratuara në planin strategjik të zhvillimit për 3 vitet e ardhshme; (iii) ndryshimet e politikave fiskale të miratuara në nivel kombëtar; (iv) trendi historik i realizimit të të ardhurave në fakt minimalisht në tre vitet e kaluara; (v) fondet e trashëguara të paangazhuara nga viti i kaluar; (vi) të ardhurat shtesë që mund të realizohen nga detyrime tatimore të pambledhura në kohë (që përfshin vleresimin e të gjithë situatës që sjell përmirësimin e administrimit tatimor si p.sh futja e sistemit të informatizuar të taksave, etj). (vii) Struktura koordinuese përgjegjëse për parashikimin e të ardhurave mund të përdori edhe metoda të ndryshme parashikimi, të cilat përfshijnë sa më shumë informacion, krahasime dhe përpunime të tyre, me synimin për të rezultuar ne një qasje realiste në parashikimin e dokumentit final që bëhet pjesë e buxhetit vjetor të Bashkise. (viii) Parashikimet për ecurinë e të ardhurave në tre vitet e ardhshme, duke u bazuar në gjithshka më lart dhe gjykimin më të mirë të ekspertizës përkatëse në bashki. Të ardhurat e tjera që nuk vijnë nga parashikimi, por si pjesë e ligjit të buxhetit të shtetit (transferta të kushtëzuara / të pakushtëzuara/ taksat e ndara) nuk përbëjnë pjesë kryesore në analizën për parashikimin e të ardhurave vendore.

	Raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm miratohet nga Këshilli Bashkiak deri në 1 Mars të vitit aktual, miratim që ndiqet me miratimin e tavaneve të shpenzimeve deri në 15 Mars. **Ne vijimesine e procesit** të parashikimit afatmesëm më të detajuar të të ardhurave vendore, përditësohet parashikimi i të ardhurave vendore bazuar në: (i) përllogaritjet e detajuara mbi bazën e tatueshme dhe deklarimet tatimore të taksapaguesve për vitin aktual ku marrin pjesë të gjitha strukturat që gjenerojnë të ardhura nga taksat dhe tarifat në bashki; (ii) kostot e shërbimeve vendore. Kjo fazë kryhet paralelisht me saktësimin e deklaratave të programeve buxhetore të shpenzimeve për 3 vitet e PBA nga ana e ekipeve të programeve. Parimi: Niveli i Tarifes se sherbimit orientohet ne mbulimin e kostove te sherbimit. Mbahet parasysh mbulimi i shpenzimeve baze dhe programeve te zhvillimit si nevoja per te krijuar mundesine e realizimit te objektivave dhe qellimit të funksionimit te Bashkise; (iii) bazat e të dhënave për parashikimet e të ardhurave nga menaxhimi i aseteve dhe të tjera jo tatimore që llogariten nga të gjithë departamentet që gjenerojnë të ardhura në bashki. (iv) analizën e risqeve nga koordinatorët e gjithë strukturave që gjenerojnë të ardhura dhe llogaritjen e efekteve financiareqë sjellin politikat e reja të planit të zhvillimit vendore për 3 vitet e ardhshme dhe ndryshimet më të fundit te kuadrit ligjor kombëtar (p.sh nevojat për fonde buxhetore shtesë për administrimin e të ardhurave siparapagesa për shërbimet e ASHK, futja e sistemeve të menaxhimit të aseteve dhe të ardhurave të bashkisë, kosto operative të tjera). Faza e mësipërme udhehiqet nga Koordinatori i GMS (Nenkryetar/SP) si Kryetar i Grupit per Parashikimin e te Ardhurave dhe mbaron deri në datën 31 Maj me hartimin e: (i) draftit të parë të parashikimit të të ardhurave afatmesme të shoqëruar me listën e detajuar të të gjitha taksave, tarifave e cdo lloj të ardhure tjetër nga asetet dhe të tjera jotatimore, të parashikuara për tu mbledhur nga Bashkia në tre vitet e ardhme; (ii) raportit të efekteve financiare apo diferencave midis të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara në PBA, të shoqëruar me ndryshimet e pritshme në politikat fiskale vendore, nivelin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor fiskal dhe risqet e vlerësuara. Pas komunikimit dhe marrjes se komenteve nga Ministria e Financave së bashku më shifrën e transfertës së pakushtëzuar të caktuar për bashkinë në 3 vitet e ardhme, dokumentet e mësipërme miratohen në Këshillin Bashkiak deri ne fund te muajit Qershor. **Faza II –Përditësimi dhe konsolidimi i dokumenteve** të hartuara gjatë fazës së dytë, konkretisht (i) Raporti i ndryshimeve të pritshme në paketën fiskale pas konsiderimit të VKB datë 30 Qershor; (ii) parashikimi i të ardhurave afatmesme dhe lista sipas tipologjisë së të ardhurave, i përditësuar me ndryshimet sipas VKB datë 30 qershor me fokus parashikimin vjetor të detajuar për vitin pasues dhe (iii) konsultimi publik për ndryshimet e miratuara në paketën fiskale deri në datën 5 Shtator të vitit aktual. Kjo fazë përfundon në datën 15 Shtator me miratimin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar në Këshillin Bashkiak. Ka një interval kohor të dytë komunikimi me Ministrinë e Financave që përfundon në datën 5 tetor të vitit fiskal. **Faza III – Hartimi i Projekt buxhetit vjetor dhe dokumentit final të PBA** ku përfshihen: (i) propozimet për ndryshimet e paketës fiskale, përditësuar me ndryshimet që sjell vendimi i KB në 15 shtator dhe komentet e MFE; (ii) parashikimi vjetor perfundimtar sipas tipologjisë së të ardhurave, përditësuar me ndryshimet më të fundit të legjislacionit nacional, komentet e

	MFE dhe ndryshimet në paketën fiskale sipas vendimit të KB së datës 15 Shtator; (iii) caktimi/rishikimi i afateve te pagesave ne paketen fiskale (afatet e pageses se detyrimeve vendore), si nje proces i integruarme procesin e hartimit te planit te flukseve te arkes se buxhetit duke marre ne konsiderate, natyren e bizneseve ne gjenerimin e te ardhurave dhe/ose ndarjen me keste te pagesave gjate periudhes (p.sh bizneset sezonale, levizjen e popullsise, etj). Mund te analizohet ne kete faze edhe kontraktimi i nje agjenti tatimor, duke u fokusuar kryesisht ne analizen e raporteve financiare të agjentit, mbulimin territorial, bazen e te dhenave në përdorim prej tij, nivelin e arketimeve te produktit kryesor. Kjo fazë mbaron në datën 30 Nëntor të vitit fiskal aktual me dërgimin e dokumentit të PBA për miratim përfundimtar në Këshillin Bashkiak. **Programi buxhetor afatmesëm përfundimtar** miratohet nga Këshilli Bashkiak jo më vonë se **data 25 Dhjetore** vitit aktual. Paketa Fiskale e rishikuar azhornohet/"zbardhet" me ndryshimet e fundit sipas VKB përfundimtare dhe publikohet në faqen e internetit të bashkisëbrenda 15 ditëve nga miratimi në Këshill Bashkiak. Parashikimi vjetor i të ardhurave të bashkisë finalizohet/"zbardhet" njëkohësisht ose pas miratimit përfundimtar të ndryshimeve në paketën fiskale të bashkisë deri në 1 Janar të vitit pasardhës. Për përshkrimin e detajuar te PAV referohuni në Seksionin 2. Përshkrimi i Detajuar i Procesit "Parashikimi i të Ardhurave Vendore".
Dokumentet kryesore dhe sistemet mbeshtetëse të informacionit.	- Të ardhurat vendore të arkëtuara dhe realizuara në 3 vitet e mëparshme (korrespondence e brendshme) - Treguesi makro dhe demografike (ekonomia, bizneset, popullsia, nivelet e punësimit) (korrespondencë zyrtare) - Vendimi Këshillit dhe ndryshimet ligjore për paketën fiskale për vitin në vijim dhe atë aktual (kopje letër, ose elektronike) - Regjistri i bizneseve dhe statusi i tyre (format elektronik) - Treguesit socialë (papunësia, ndihma sociale, paaftësia, kontributet) (korrespondencë zyrtare) - Sistemi elektronik i te ardhurave vendore -Plani i flukseve te arkes (afatet e pagesave te pageses fiskale)
Rrisqet e identifikuara dhe të reflektuarane kete dokument	1. Mungesa e nje Plani strategjik apo afatmesëm i menaxhimit të të ardhurave dhe/ose Plani Operacional mbështetur në objektiva të matshme, për të ndihmuar vendimarrjen, pajtueshmërinë vullnetare të taksapaguesve, si dhe për të rishikuar procesin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në afat (S.PAV & MDMSH-1). 2. Proces i paqartë ose konfuz sa i takon ndarjes së detyrave, përgjegjësive dhe afateve kohore tëparashikimit të të ardhurave (efektiviteti i kontrolleve të brendshme). 3. Vlerësim i gabuar tatimor bazuar mbi të dhëna të pjesshme ose të pasakta (RMO.PAV & MNA-2). 4. Paqartesi ne bazen e taksueshme per tarifat e sherbimeve publike (O.PAV-10) 5. Ndërhyrjet e vazhdueshme/ndryshimet te shpeshta nga qeverisja qendrore ne politika fiskale që dëmtojnë procesin e parashikimit të të ardhurave nënivel vendor. 6.Natyra e bizneseve dhe niveli i qarkullimit te parase/plani i arkës (mungesë koordinimi midis strukturave) merret pak në konsideratë ne parashikimin e afateve të arkëtimit të detyrimeve tatimore. Për detaje mbi planet e menaxhimit të risqeve te Menaxhimit të të Adhurave, PAV-1 të identifikuara, vlerësuara dhe adresuara per ndjekje te metejshme, referohuni ne Regjistrin e Risqeve për Menaxhimin e të Ardhurave Vendore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

MIRATOHET:

KRYETARI

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

PROCESET PËR PLANIFIKIMIN DHE KONTROLLIN E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
(GJURMËT E AUDITIT)

2. PROCESI I HARTIMIT TË PDV

DREJTOR:
ENKELEJDA JONUSLLARI

- **PROCESI I HARTIMIT TË PDV-SË:**

Një gjurmë auditi për këtë process shërben si një document kronologjik që vërteton se hapat ligjorë janë ndjekur me përpikmëri, duke garantuar transparencës dhe ligjshëmrinë.

Faza I: Iniciativa dhe vendimmarrja për nismën

Kjo fazë dokumenton zanafillën e procesit dhe autorizimin ligjor.

- **Vendimi i Kryetarit të Bashkisë:** Dokumenti që autorizon nisjen e hartimit të PDV-së.
- **Njoftimi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT):** Konfirmimi i dërgimit të njoftimit për nisjen e procesit në regjistrin e planifikimit.
- **Termat e Referencës (ToR):** Përcaktimi i qëllimit, kufijve të zonës dhe objektivave zhvillimore.

Faza 2: Hartimi Teknik dhe Konsultimi Publik

Këtu auditi fokusohet te pjesëmarrja e publikut dhe përputhshmëria teknike me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV).

- **Relacioni Teknik:** Përshkrimi i gjendjes ekzistuese dhe propozimi i ri.
- **Dokumentacioni i Konsultimit Publik:** * Njoftimi i takimit (15 ditë para zhvillimit).
    - Procesverbali i dëgjimit publik.
    - Lista e pjesëmarrësve dhe fotografitë e takimit.
    - Trajtimi i ankesave/sugjerimeve të qytetarëve.
- **Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM):** Raporti për ndikimin në mjedis (nëse kërkohet sipas kategorisë).

Faza 3: Miratimi dhe Regjistrimi

Faza finale që i jep fuqi ligjore dokumentit.

- **Mendimi Teknik i AKPT-së:** Shkresa zyrtare që vërteton përputhshmërinë e PDV-së me planet e nivelit më të lartë.
- **Vendimi i Këshillit Bashkiak / Kryetarit:** Akti i miratimit të PDV-së.
- **Publikimi në Regjistrin e Planifikimit (e-planifikimi):** Gjurma digjitale që vërteton hyrjen në fuqi.

Faza e procesit	Veprimi Administrativ	Dokumenti Justifikues	Referenca Ligjore (Legjislacioni)
1. Iniciimi	- Vendimi për nismën e procesit të PDV-së	Vendimi i Kryetarit të Bashkisë / Kryetarit të Këshillit Bashkiak	Ligji 107/2014 Rregullorja e Planifikimit të Territorit
	- Njoftimi i autoriteteve	Shkresë zyrtare drejtuar AKPT-së dhe Ministrisë përgjegjëse	Ligji 107/2014
	- Publikimi i nismës	Njoftimi në faqen web të Bashkisë dhe Regjistrin e Planifikimit (e-planifikimi)	Ligji 107/2014 Rregullorja e Planifikimit të Territorit
2. Planifikimi	- Përcaktimi i kufijve	Harta e zonës së PDV-së (GIS/AutoCad)	Termat e Referencës
	- Hartimi i dokumentit	Relacioni teknik dhe rregullorja e PDV-së	Neni 28 Ligji 107/2014
3. Konsultimi	- Njoftimi i takimit/konsultimit publik	Njoftimi 15 ditë para në media lokale/web	Neni 24 Ligji 107/2014
	- Zhvillimi i konsultimit publik	Procesverbali i takimit + lista e pjesëmarrësve	Neni 24 Ligji 107/2014
	- Reflektimi i sygjerimeve nga pjesëmarrësit	Raporti i shqyrtimit të ankesave/ vërejtjeve/ sygjerimeve	Rregullorja e Planifikimit
4. Koordinimi mes institucioneve	- Mendimi i AKPT	Shkresa zyrtare e konfirmimit të AKPT	Ligji 107/2014
	- Mendimi i banorëve	Dakordësia e banorëve që kanë në pronësi më shumë se 1/3 e sip.	Ligji 107/2014
	- Vlerësimi Mjedisor	Deklarata Mjedisore	Ligji për VSM

			(nëse aplikohet)	
5. Miratimi	-	Vendimi final	Vendimi i Kryetaritt ë Bashkisë	Ligji 107/2014
6. Publikimi	-	Hyrja në fuqi	Botimi në Regjistrin e Planifikimit (e-planifikimi)	Ligji 107/2014
7. Regjistrimi	-	Regjistrimi në ASHK i vendimit final (jo më vonë se 15 ditë pas botimit në regjistër)	Shkresë zyrtare në ASHK	Ligji 107/2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E BURIMVE NJERËZORE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Maliq, më 30 . 09 .2025

Lënda: GJURMËT E AUDITIT PËR VITIN 2025

1. Qëllimi dhe Fusha e Veprimit

Ky dokument përshkruan gjurmët e auditit për vitin 2025 për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun (DBNJM), në përputhje me Planin e Punës 2025. Qëllimi është të sigurohet transparencë, gjurmueshmëri, përputhshmëri ligjore dhe efikasitet në proceset e BNJ dhe MP.

Fusha e veprimit:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Zhvillimi dhe vlerësimi i stafit
- Administrimi i pagave dhe përfitimeve
- Marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi institucional
- Menaxhimi i dokumentacionit dhe arkivës
- Menaxhimi i infrastrukturës IT
- Administrimi i sistemeve dhe aplikacioneve
- Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave
- Mbështetja teknike për stafin
- Menaxhimi i dokumentacionit dhe aseteve IT

2. Baza Ligjore dhe Dokumentuese

- Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për administratën publike
- Rregulloret e brendshme dhe politikat e institucionit
- Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Aktet nënligjore për sigurinë kibernetike
- Plani i Punës i DBNJM për vitin 2025
- Manualet e procedurave dhe udhëzimet përkatëse

3. Parimet e Auditimit

- Ligjshmëria
- Efektiviteti dhe efikasiteti

- Transparenca dhe llogaridhënia
- Ndarja e detyrave
- Dokumentimi i plotë dhe i saktë

4. Gjurmët e Auditit sipas Proceseve

4.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Objektivi: Sigurimi i rekrutimit, emërimit dhe administrimit korrekt të stafit.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente/Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Planifikimi i nevojave për staf	Analiza vjetore e nevojave	Plan i miratuar i stafit	Drejtori BNJ	Janar 2025	Miratim nga titullari
Rekrutimi dhe përzgjedhja	Procedurat e konkursit	Shpallje, procesverbale, lista vlerësimi	Njësia BNJ	Gjatë vitit	Verifikim dokumentacioni
Emërimi/kontraktimi	Formalizimi i marrëdhënies së punës	Vendime, kontrata	BNJ	Gjatë vitit	Kontroll ligjor

4.2 Zhvillimi dhe Vlerësimi i Performancës

Objektivi: Rritja e kapaciteteve dhe vlerësimi objektiv i stafit.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente/Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Trajnimet	Identifikimi dhe realizimi	Plane trajnimi, certifikata	BNJ	Sipas planit	Raportim periodik
Vlerësimi i performancës	Vlerësim vjetor	Formularë vlerësimi	Eprorët	Dhjetor 2025	Rishikim nga BNJ

4.3 Administrimi i Pagave dhe Përfitimeve

Objektivi: Pagesa e saktë dhe në kohë e stafit.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente/Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Përllogaritja e pagave	Llogaritja mujore	Lista pagese	BNJ/Financa	Mujore	Krahasim me kontratat

Përfitimet shtesë	Leje, shpërblime	Vendime, kërkesa	BNJ	Gjatë vitit	Autorizim paraprak

4.4 Marrëdhëniet me Publikun

Objektivi: Informim korrekt dhe në kohë i publikut dhe medias.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente/Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Njoftime për publikun	Publikime zyrtare	Njoftime, postime	Njësia MP	Gjatë vitit	Miratim përmbajtjeje
Menaxhimi i kërkesave	Trajtimi i ankesave/kërkesave	Regjistër kërkesash	MP	Afate ligjore	Monitorim afatesh

4.5 Menaxhimi i Dokumentacionit dhe Arkivës

Objektivi: Ruajtja dhe gjurmueshmëria e dokumenteve.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente/Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Arkivimi	Sistemimi i dokumenteve	Regjistër arkive	BNJ/MP	Vazhdimisht	Inventar periodik
Qasja në dokumente	Autorizimi i aksesit	Lista autorizimesh	Drejtori	Sipas nevojës	Kontroll aksesesh

4.6 Menaxhimi i Infrastrukturës IT

Objektivi: Sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm të rrjeteve, serverëve dhe pajisjeve IT.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente / Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Inventarizimi i pajisjeve	Regjistrimi dhe përditësimi i aseteve IT	Regjistër inventari	IT	Janar 2025	Verifikim fizik
Mirëmbajtja teknike	Servis periodik	Raporte mirëmbajtjeje	IT	Gjatë vitit	Kontroll funksional
Menaxhimi i rrjetit	Monitorim i rrjetit LAN/WAN	Log-e, raporte	IT	Vazhdimisht	Monitorim aksesesh

4.7 Administrimi i Sistemeve dhe Aplikacioneve

Objektivi: Funksionim i sigurt dhe korrekt i sistemeve elektronike.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente / Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Menaxhimi i përdoruesve	Krijim/fshirje aksesesh	Kërkesa, lista përdoruesish	IT	Gjatë vitit	Autorizim me shkrim
Përditësimi i sistemeve	Update dhe patch	Raporte teknike	IT	Periodik	Testim paraprak
Backup i të dhënave	Kopje rezervë	Log-e backup	IT	Ditor/Javor	Test rikuperimi

4.8 Siguria e Informacionit dhe Mbrojtja e të Dhënave

Objektivi: Parandalimi i humbjes, keqpërdorimit ose aksesit të paautorizuar.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente / Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Politikat e sigurisë	Hartim dhe zbatim	Politika të miratuara	IT/Drejtoria	Vjetore	Rishikim periodik
Antivirus & Firewall	Instalimi dhe monitorimi	Raporte sigurie	IT	Vazhdimisht	Alarm & log-e
Menaxhimi i incidenteve	Trajtimi i rasteve	Regjistër incidentesh	IT	Sipas rastit	Raportim zyrtar

4.9 Mbështetja Teknike për Stafin

Objektivi: Sigurimi i asistencës teknike për punonjësit e bashkisë.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente / Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Trajtimi i kërkesave	Support teknik	Regjistër kërkesash	IT	Ditor	Monitorim afatesh
Trajnimi bazë IT	Rritja e aftësive	Plane & lista pjesëmarrjeje	IT	Sipas planit	Vlerësim pas trajnimit

4.10 Menaxhimi i Dokumentacionit dhe Aseteve IT

Objektivi: Administrimi korrekt i dokumentacionit dhe licencave.

Aktiviteti	Përshkrimi	Dokumente / Evidenca	Përgjegjësi	Afati	Kontrolli i Brendshëm
Licencat software	Monitorim i vlefshmërisë	Kontrata, licenca	IT	Vjetore	Kontroll ligjor

Arkivimi teknik	Ruajtja e dokumenteve	Dosje teknike	IT	Vazhdimisht Inventar vjetor

5. Raportimi dhe Monitorimi

- Raporte tremujore dhe vjetore mbi zbatimin e planit
- Evidentimi i mospërputhjeve dhe masat korrigjuese
- Ndjekja e rekomandimeve të auditit të brendshëm/jashtëm

6. Përfundime

Gjurmët e auditit për vitin 2025 shërbejnë si mjet kyç për sigurimin e integritetit, përputhshmërisë dhe performancës së DBNJM, në përputhje me Planin e Punës 2025.

Drejtori i Drejtorisë

Fation Fasho

MIRATOI:

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ